




GRATË NË BIZNES PËR NJË EKONOMI TË ZHVILLUAR



DONATORËT



QEVERIA E KOSOVËS



AGJENCIA AMERIKANE PËR
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
(USAID)



BANKA GJERMANE PËR ZHVILLIM
(KfW)

BASHKËPUNËTORËT



AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (SIDA)



BANKA BOTËRORE (BB)



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të
Fondit për Garantimin e Kredive të krijuar sipas Rregullores (EU) Nr
1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e
Programit për Konkurrencë dhe Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve
të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020).



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)



MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO

FONDACIONI KOSOVAR I MILENIUMIT (MFK)

INSTITUCIONET FINANCIARE PARTNERE



PËRMBAJTJA

- 04 **PARATHËNIE**
- 06 **OPINIONE**
Gratë ndërmarrëse në Kosovë - Mundësitë dhe sfidat
- 10 **INTERVISTË**
Të jesh grua në pozitë udhëheqëse
- 12 **OPINIONE**
Rrjetet dhe rrjetëzimi i grave
- 15 **OPINIONE**
Pse mungojnë gratë në tryezë të vendimmarrjes?
- 18 **STORIE SUKSESI**
Shtëpia e Djathit - NATYRA G
- 20 **KËNDI I LAJMEVE 2021**
- 20 FKGK pjesë e panelit në webinar "financat e qëndrueshme për institucionet financiare"
- 20 FKGK fillon me zbatimin e plotë të menaxhimit mjedisor dhe social
- 20 Mbahet forumi i solarëve
- 20 Publikohet Raporti Vjetor 2020
- 21 FKGK lanson Dritarën Start-Up në kuadër të dritareve të pakos së rimëkëmbjes ekonomike
- 21 Nënshkruhet marrëveshja e garancisë me kreditimin rural të Kosovës
- 22 FKGK mbanë takime virtuale me gra në biznes - organizuar nga RIINVEST
- 22 Sesione orientuese për Dritaren Start-Up
- 22 FKGK mbanë takime virtuale me Start-Up, në bashkëpunim me GIZ
- 22 Trajnime për stafin e KRK-së - Dritarja Agro – përdorimi i Agrosoft-it
- 23 U mbajt punëtorja me gazetarë - Gazetaria ekonomike dhe financiare 2021 "Të bëjmë lajme nga numrat"
- 24 Trajnime për kategorizimin mjedisor – politikat e menaxhimit mjedisor dhe social
- 24 Pjesëmarrja e stafit të FKGK-së në panele diskutimesh "Java e ndërmarrësisë globale"
- 24 Qasja në financa për Start-Up
- 25 Gjermania mbështet FKGK-në
- 25 FKGK pjesë e panelit organizuar nga programi i USAID - Kosovo Compete Activity
- 26 **FKGK NË MEDIA**

Të nderuar lexues,

Buletini i FKGK-së ka një mision të thjeshtë—të informojë publikun për punën, iniciativat dhe aktivitetet e institucionit tonë si dhe synimin për ti informuar lexuesit rreth ngjarjeve me interes ekonomik dhe financiar, duke rritur kështu transparencën ndaj publikut.

Edicioni i tretë i është kushtuar një teme të veçantë e që është "Gratë në Biznes" si temë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të çdo shoqërie.

Gjithashtu, në këtë edicion janë listuar aktivitetet e FKGK-së nga muaji korrik deri në fund të muajit dhjetor 2021 sepse jemi dëshmitarë të një periudhe mjaft dinamike ku janë përfshirë seri aktivitetesh si: trajnime, nënshkrime marrëveshjesh me partnerë, prezencë në media, sesione orientuese për partnerët tanë si dhe shumë aktivitete tjera.

Lexim të këndshëm!

Opinionet, mendimet dhe analizat e shprehura përmes artikujve të botuar nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e FKGK-së apo qasjen e Institucionit ndaj të njejtave.



Të nderuar lexues,

Kam nderin dhe kënaqësinë ta shkruaj parathënien për edicionin e tretë të buletinit të FKGK-së. Në këtë numër, kemi vendosur që të diskutojmë për gratë në biznes, si një force dominuese dhe me rritje në pronësinë e bizneseve të vogla.

Ndërmarrësia luan rol shumë të rëndësishëm në fuqizimin ekonomik të gruas. Studimet shkencore tregojnë që fuqizimi ekonomik i gruas dhe, rrjedhimisht, barazia gjinore ndikojnë në avancimin e ekonomive dhe zhvillimin e qëndrueshëm, meqë gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së botës.

Përderisa gratë ndërmarrëse përbëjnë mbi një të tretën e të gjithë ndërmarrësve në botë, në Kosovë kjo përqindje është shumë më e ulët dhe sillet rreth 13%.

Njëra ndër barrierat kryesore për gratë është kapitali fillestar për të nisur një biznes. Pjesa dërmuese e grave nuk trashëgojnë pronë, prandaj, mungesa e kolateralit si dhe mungesa e historisë së biznesit e vështirësojnë edhe më tej qasjen në financa.

Për më tepër, qëndrimet gjinore, normat dhe besimet shoqërore krijojnë pengesa shtesë për gratë që e vështirësojnë fillimin ose rritjen e një ndërmarrjeje afariste për to. Përkundër këtyre sfidave, viteve të fundit vërehet një trend pozitiv i rritjes së bizneseve që drejtohen nga gratë.



ARTA HOXHA

Anëtare e Bordit Menaxhues – Kryesuese e Komitetit të Auditimit - FKGK

Pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht në NMVM-të që kanë kapacitet të kufizuar për t'i absorbuar goditjet e pandemisë për shkak të inventarit më të vogël, bazës më të vogël të klientëve dhe opsioneve më të kufizuara për qasje në financa në krahasim me ndërmarrjet më të mëdha.

Këto sfida kanë qenë edhe më të theksuara për bizneset e grave, meqë gratë kryesisht janë pronare të mikrobizneseve në sektorët më të goditur nga pandemia COVID-19.

Në lidhje me këtë, FKGK ka futur në objektivat e veta institucionale ofrimin e mundësive më të mira për sektorët dhe kategoritë më pak të shërbyera të ekonomisë dhe popullsisë, duke përfshirë gratë.



Ndërmarrësia luan rol shumë të rëndësishëm në fuqizimin ekonomik të gruas. Përderisa gratë ndërmarrëse përbëjnë mbi një të tretën e të gjithë ndërmarrësve në botë, në Kosovë kjo përqindje është shumë më e ulët dhe sillet rreth 13%.

Që nga themelimi i FKGK-së, pjesëmarrja e kredive të garantuara për gratë në biznes është mbi 12%. Përveç kësaj, FKGK, përmes Projektit për Fuqizimin e Sektorit Bankar të financuar nga Banka Botërore, ka lansuar një dritare të veçantë me kushte më të favorshme për ndarjen e rrezikut kreditor me banka partnere, e cila e mundëson mbulimin e rrezikut deri në 80% për ndërmarrjet ku gratë janë pronare apo bashkëpronare.

Për më tepër, me shumë krenari ju ftoj t'i lexoni artikujt e përzgjedhur në këtë botim dhe njëkohësisht i falënderoj mysafirët tanë për pasurimin e këtij buletini me shkrimet e tyre. Shpresoj se të gjithë do të kënaqeni duke lexuar këtë botim dhe presim me padurim komentet tuaja.

Në fund, ju uroj të gjithëve një Vit të Ri të lumtur, të begatë dhe plot shëndet!



GRATË NDËRMARRËSE NË KOSOVË MUNDËSITË DHE SFIDAT

Me përjashtime të vogla të storieve të suksesit, gratë në Kosovë përballen me vështirësi të mëdha në përfshirjen e tyre në jetën ekonomike, qoftë në cilësinë e punëdhënësës qoftë punëmarrëses. Ndonëse gratë përfaqësojnë gjysmën e popullsisë së Kosovës, angazhimi i tyre aktiv në veprimtari ekonomike mbetet mjaft i ulët në krahasim me atë të burrave. Përfaqësimi i barabartë i grave në sferën publike e ekonomike është parakusht për zhvillimin ekonomik të vendit.

Më shumë gra të punësuar nënkupton, mes tjerash, më shumë vende të reja të punës, përmirësim të mirëqenies familjare, ulje të varfërisë, si dhe ngritje më të lartë të nivelit të arsimit në vend. Zhvillimi i ndërmarrësisë është i ndërlidhur ngushtë me krijimin e vendeve të reja të punës, mundësive për investime të reja, inovacione dhe qasje më kreative për zgjidhje të problemeve. Themelimi i biznesit në Kosovë nuk ka shpenzime, mirëpo qasja në financa konsiderohet si një prej pengesave kryesore për ndërmarrjet në pronësi të grave.

Sipas të dhënave vetëm 11.42% të të gjithë ndërmarrësve në Kosovë janë gra, me trend në rritje por me zhvillim shumë të ngadaltë. Krahasuar me nivelin global të shteteve me të ardhura të ulëta, ku gratë ndërmarrëse përbëjnë 37%, mund të themi se ende duhen politika më të favorshme për fuqizimin e grave në Kosovë.

Edhe pse gratë ndërmarrëse përballen me sfida të shumta, motivimet kryesore që shtyjnë gratë të hapin biznese vazhdojnë të jenë sigurimi i mirëqenies më të mirë për to dhe familjen, mundësia e fitimeve financiare dhe rritja e punësimit.

Të dhënat tregojnë se gratë ndërmarrëse janë kryesisht të fokusuar në sektorin e shërbimeve (sallone të bukurisë), tregti dhe shitje me shumicë dhe pakicë, edukim,



SAXHIDE MUSTAFA

Z. Drejtoreshë Ekzekutive
INSTITUTI RIINVEST

shëndetësi, ndërsa më pak në përpunim të ushqimit, hoteleri e turizëm. Afërsisht rreth 95% e ndërmarrjeve të grave janë mikro dhe të vogla. Kur flasim për formën e regjistrimit ato janë kryesisht biznese individuale (78.6%), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (20.4%), ortakëri (0.51%) dhe të tjera (0.49%).



Afërsisht rreth 95% e ndërmarrjeve të grave janë mikro dhe të vogla. Kryesisht biznese individuale (78.6%), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (20.4%), ortakëri (0.51%) dhe të tjera (0.49%).

Zhvillimi i ngadalshëm ekonomik në dy dekadat e fundit si pasojë e luftës ka krijuar një mjedis të pafavorshëm, por edhe angazhimi i shtetit ka qenë i pamjaftueshëm në lehtësimin e të bërit biznes përkundër reformave të arritura. Marrë parasysh se gratë ndërmarrëse konsiderohen kontribuuese të rëndësishme në ekonomi, shumë prej tyre punojnë ose janë të përfshira në sektorin joformal, prandaj edhe kontributi i tyre i vërtet mbetet i paregjistruar dhe në hije.

Gratë ndërmarrëse ballafaqohen me barriera të ndryshme, qofshin ato të brendshme apo të jashtme, siç janë: mungesa e shkathësive menaxheriale, menaxhimi i zinxhirit të vlerës, barriera financiare e administrative, tregu i vogël, mungesa e pajisjeve adekuate e moderne sipas standardeve ndërkombëtare dhe, si barrierë kryesore, mungesa e posedimit të pronës që reflekton në mungesë të qasjes në burime të financimit etj. Nga gjithsej 11.42% gra ndërmarrëse, vetëm 21% e tyre kanë në pronësi lokalet afariste ku ato operojnë, ndërkaq vetëm 12% e tyre kanë marrë kredi në institucione financiare për qëllime të investimeve.

Balancimi i punës dhe jetës është i pamundur pa ndërlikohen e politikave publike. Ligji i punës gjithashtu mbetet pengesë shumë e madhe, sidomos në kuptim të dispozitave të pushimit të lehonisë. Duke e pasur parasysh se për nga natyra gratë ndërmarrëse punësojnë më shumë gra, ato janë duke u përballë me vështirësi të shumta për sa i përket pagesës së pushimit të lehonisë. Një situatë e tillë mund të ndryshohet nëse kjo barrë ndahet në një mënyrë më të ekuilibruar midis sektorit publik, sektorit privat dhe ekonomive familjare. Për disa vite Forumi Ekonomik i Grave dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile janë duke avokuar që pagesa e pushimit të lehonisë të rregullohet në favor të sektorit privat dhe sektorit të OJQ-ve të cilat kanë punësim të lartë të grave. Odat ekonomike, po ashtu, e kanë përkrahur këtë iniciativë, që barra e pushimit të lehonisë duhet të bie në shtetin.



Gratë ndërmarrëse ballafaqohen me barriera të ndryshme. Por, si barrierë kryesore është mungesa e posedimit të pronës që reflekton në mungesë të qasjes në financa.

Përmirësimi i pozitës së grave në ekonomi është sfidë për të gjithë shoqërinë. Duhet të rritet vetëdijesimi i grave punëdhënëse dhe punëmarrëse për pjesëmarrjen e tyre në tregun formal, sepse kjo do të ndihmojë që ato të zhvillohen dhe të kenë pozitë më të mirë në shoqëri. Qeveria duhet të ndërmarrë masa të mëtejme për avancimin e e përmirësimin e politikave për fuqizimin ekonomik të grave.

Në dekadën e fundit qeveria qendrore dhe ato lokale kanë krijuar kushte dhe kriteret stimuluuese për gratë ndërmarrëse për përfitim nëpërmjet granteve dhe subvencioneve mirëpo praktika ka treguar se menaxhimi i granteve dhe subvencioneve nga qeveria qendrore dhe lokale ka qenë proces me menaxhim jo të mirë dhe i lidhur me afera korruptive. Kjo është për të ardhur keq, sepse shumë gra ndërmarrëse mbesin pa stimulim ndërkohë që grantet shpeshherë përfundojnë në kompani fiktive.

Organizatrat dhe agjencitë ndërkombëtare, po ashtu, kanë luajtur rol mjaft të madh për fuqizimin ekonomik të grave në Kosovë, nëpërmjet ofrimit të trajnimeve, ndarjen e granteve për pajisje për prodhim dhe shërbime të tjera, pjesëmarrjen e tyre në vizita studimore e panairë dhe promovimin e produkteve të tyre.

Fondi Kosovar për Garantim të Kredive, si institucion mjaft i rëndësishëm, është incentiv shtesë për krijimin e mundësive për gratë ndërmarrëse nëpërmjet garantimit të kredive. Ky institucion duhet të jetë më i pranishëm në publik, në takime me biznese që promovojnë punën e tyre. Banka Qendrore e Kosovës dhe Fondi Kosovar për Garantim të kredive mund të krijojnë incentiva shtesë, sikurse janë subvencionimi i interesit bankar ose edhe dhënie e grejs periudhës 1-2 vite për gratë afariste. Përkrahja e grave përgjatë këtyre viteve ishte e favorshme dhe pa dyshim që do të ketë ndikim në lehtësimin e qasjes në kredi nëpërmjet formave të kredive të përshtatura enkas për këtë kategori, si dhe përmes skemave garantuese, mirëpo numri i tyre mbetet ende i vogël.

Qeveria qendrore dhe ato lokale duhet të vazhdojnë tutje të ofrojnë mbështetje dhe të zhvillojnë masa afirmative për përkrahjen e grave ndërmarrëse, si dhe të përmirësojnë kornizën ligjore dhe rregullative, me fokus në dispozitat e ligjit të punës etj. Gratë ndërmarrëse kanë nevojë të domosdoshme për përkrahje


përmes ofrimit të trajnimeve në fushën e ngritjes së shkathtësive menaxhuese, plotësimin të standardeve dhe rritjes së cilësisë së produktit, bashkëpunimit në mes të kompanive, si dhe krijimit të sinergjive në biznes, krijimit të mirëbesimit në mes të kompanive. Digjitalizimi i proceseve të ndërmarrjes është proces i domosdoshëm në ditët e sotme dhe kjo mbetet ende sfidë e madhe. Ballafaqimi me Pandeminë Covid-19 ka vënë në pah nevojën të shumta për avancim të sistemit të pagesave përmes shitjeve online. Sistemit i pagesave me Paypal është kërkesë e shumë ndërmarrjeve të grave në Kosovë dhe sistemi bankar në Kosovë duhet të avancojë në këtë aspekt.

Çekuilibrimi gjinor në shoqëri mund të zvogëlohet duke rritur angazhimin kolektiv në shoqëri lidhur me rolet gjinore, promovimin dhe respektimin e politikave të qarta të barazisë gjinore nga qeveritë dhe shoqëria në përgjithësi. Më shumë pjesëmarrje e grave në jetën ekonomike nënkupton familje më të shëndosha dhe shoqëri më prosperuese.






KREDITË E MIRATUARA



KREDITË SIPAS SEKTORËVE



RRITJA E QARKULLIMIT

Deri më 31 dhjetor 2021

10,064
kredi për NMVM-të



495.7 milionë euro

apo mbi 11% rritje të qarkullimit mbi bazën e tanishme të qarkullimit të NMVM-ve përkatëse



TË JESH GRUA NË POZITË UDHËHEQËSE

Intervistë me Anita Kovacic, Drejtoreshë Ekzekutive, Drejtuese e Bordit Menaxhues, Banka Raiffeisen në Kosovë

1. Çka të ka shtyrë që të synosh pozitë udhëheqëse?

Për mua, kjo ishte shumë e natyrshme. Qysh në vitet e para të karrierës sime kuptova se marrja e përgjegjësisë më jepte më shumë energji. Shumë shpesh jam paraqitur vullnetare që të marr pjesë në projekte të reja apo detyra të reja pavarësisht nëse jam ngritur në pozitë apo paguar më shumë. Gjithnjë i kam çmuar mundësitë që më janë ofruar, për të mësuar gjëra të reja dhe për ta zgjeruar profilin tim profesional. Kërshëria dhe nevoja për të mësuar gjithmonë kanë qenë busulla ime që më kanë drejtuar në pozita udhëheqëse. Përveç kërshërisë dhe pasionit, isha me fat që kam pasur mësues e mbikëqyrës të mirë, disa nga të cilët ishin mentorët dhe trajnuesit e mi. Ndërsa, tani, ka ardhur koha që unë të zbatoj atë që kam mësuar gjatë përvojës sime dhe ta ndaj me të tjerët. Pozitat e larta, sidomos pozitat udhëheqëse, kërkojnë më shumë përgjegjësi. Përveç që duhet të siguroj performancë të ekipit dhe kompanisë që udhëheq, ndikimi të të tjerët, në veçanti të kolegët që punoj çdo ditë, është përgjegjësia më e madhe. Pra, si lidere, duhet të jesh e vetëdijshme për ndikimin që krijon si brenda ashtu edhe jashtë organizatës. Nëse do e përmblihdhja përgjigjen në pyetjen tuaj mund të them se unë s'kam synuar pozitë ekzekutive, por, kur u paraqit kjo mundësi, ishte e qartë për mua që jam e përgatitur që ta marr.

2. Kur flasim për gratë në pozita udhëheqëse, si ju duket ambienti në Kosovë? Sa dallon nga Vjena apo vendet tjera që keni punuar?

Nga këndvështrimi im, më duket shumë mirë. Para tre vjetësh, kur mora pozitën e drejtueses së riskut dhe erdha në



ANITA KOVACIC
Kryeshefe Ekzekutive
RAIFFEISEN BANK KOSOVË

Kosovë, shumë miq dhe kolegë më pyesnin, athua si do të më pranojnë në ambientin/kulturën kosovare. Atëherë u jam përgjigjur, dhe ende e besoj, se qasja profesionale dhe lidhshipi që sjellë rezultate të mira dhe fokusohet në përmirësimin dhe zhvillimin e organizatës tejkalon dallimet gjinore dhe kulturore. Kur flitet për të qenit e hapur ndaj diversitetit, më duhet ta vlerësoj Kosovën për qasjen e saj ndaj shtetasve të huaj dhe faktin se na bëjnë të ndihemi si në shtëpinë tonë. Në Kosovë më kanë pranuar shumë mirë. Edhe pse jam në fazën fillestare të të mësuarit të gjuhës shqipe, nuk kam aspak problem të gjendem edhe me anglishten. Prandaj, mund të them se shkathtësitë gjuhësore janë një nga vlerat kryesore që ka Kosova dhe kjo paraqet një përparësi krahasuar me rajonin. Kur e krahasoj Kosovën me Slloveninë, Austrinë apo Kinën, vendet ku kam jetuar e punuar gjatë karrierës time, si grua lidere kam përjetuar sfidat e njëjta. Dallimi i vetëm mund të jetë në faktin se disa vende kanë më shumë përvojë me gra në pozita udhëheqëse, posaçërisht në sektorin privat, dhe janë

më aktivë dhe përkrahës ndaj grave, rrjeteve e forumeve të tyre. Në përgjithësi, sidomos gjatë vjetëve të fundit, është parë progres, ku gratë pranohen më shumë në pozita udhëheqëse sepse shtetet dhe posaçërisht institucionet ndërkombëtare duhet të përmirësojnë përfaqësimin gjinor në pozitat udhëheqëse në kompani. Kur bëhet fjalë për sektorin publik, sidomos në politikë, Kosova është shembull i mirë, sepse për të dytën herë presidencën e shtetit e udhëheq një grua.



Si lidere, duhet të jesh e vetëdijshme për ndikimin që krijon si brenda ashtu edhe jashtë organizatës. Shumë studime kanë treguar që me hyrjen e grave në tregun e punës, ato sjellin vendime më të balancuara, gjë që i bën shtetet e kompanitë të jenë më të suksesshme.

3. Sipas mendimit tuaj, a ekzistojnë sfida të veçanta për gratë në pozita udhëheqëse?

Sfidat gjithmonë i kam konsideruar si mundësi. Bazuar në përvojën time, njëra nga sfidat është se gratë shpeshherë duhet të angazhohen dhe të punojnë më shumë, në mënyrë që t'i konsiderojnë si lidere të së ardhmes. Nga gratë pritet që të jenë mirë të kualifikuara për punën në të cilën aplikojnë. Kështu ato duhet të investojnë më shumë në përgatitjen e tyre profesionale, t'i zgjerojnë më shumë njohuritë dhe përvojat e tyre, të marrin më shumë përgjegjësi, të jenë më bashkëpunuese dhe më mirë të organizuara. Kjo e fundit është edhe më sfiduese sidomos për gratë me fëmijë

dhe organizimi që duhet të bëjnë për të menaxhuar shtëpinë, edukimin e fëmijëve dhe karrierën. Nga njëra anë, kjo mund të shihet si sfida, në anën tjetër mund të jetë motiv kryesor për të investuar më shumë në karrierë. Sigurisht, kjo nuk ka të bëjë vetëm me dallimin gjinor por edhe me dallimet kulturore. Prandaj, sipas mendimit tim, zbatimi i diverstitetit do të kontribuojë në ndërtimin e besimit dhe përqafimin e një mendësie të hapur. Kur jemi duke ndërtuar besim, duhet të jemi transparent dhe të angazhohemi më shumë që të na kuptojnë dhe pranojnë. Në këtë drejtim, e vlerësoj lartë Bankën Raiffeisen, që më ka mundësuar të zhvillohem në karrierë si dhe të më pranohet puna dhe angazhimi im.

4. Në Kosovë, numri i grave në pozita udhëheqëse nëpër institucione publike është rritur shumë kohët e fundit, përderisa në biznesin privat numri i tyre ende është i ulët. Si e shihni ju rolin e gruas në udhëheqjen e biznesit?

Ju keni gra shumë të suksesshme si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. E përmenda edhe më herët, Kosova përfaqësohet nga një presidente grua ndërsa edhe dy bankat më të mëdha përfaqësohen nga gratë. E kam vërejtur se shumë gra në Kosovë kanë filluar dhe inicuar bizneset e tyre të vogla, sidomos në fushën e estetikës, modës, industrisë së tekstilit, artit e të tjera, dhe kjo është shumë gjë e mirë. Sidoqoftë, janë edhe shumë gra të cilat duhet të përkrahen në rrugëtimin e tyre profesional. Gra të cilave duhet ofruar mundësi të barabarta që ta shprehin talentin dhe ngrisin potencialin e tyre, gjë që do të pasuronte diversitetin e tregut të punës në Kosovë. Shumë studime kanë treguar që me hyrjen e grave në tregun e punës, sidomos kur ato marrin pozita udhëheqëse, ato sjellin vendime më të balancuara, gjë që i bën shtetet e kompanitë të jenë më të suksesshme.

5. Çka do t'ju sugjeronit grave që aspirojnë pozita udhëheqëse në biznes?

Të keni kurajo, guxim, vetëbesim dhe të jeni sa më profesionale. Mbi të gjitha, ndiqni ambiciet tuaja të brendshme dhe jini vetvetja!

RRJETET DHE RRJETËZIMI I GRAVE

Rrjetet dhe rrjetëzimi janë forma të organizimit të cilat për anëtarët e tyre mundësojnë krijimin e vlerave të ndryshme, ku qëllimi është që të gjithë pjesëmarrësit dhe kontribuuesit në këtë rrjet të jenë përfitues, në një formë a tjetër. Pa marrë parasysh fushën socio-ekonomike në të cilën një entitet mund të bëjë pjesë, përfshirja në një rrjet parasheh përfitim dhe shtim të vlerës për atë entitet.

E njëjta vlen edhe për fushën e ndërmarrësisë, ku bizneset e ndryshme shfrytëzojnë rrjetet dhe benefitet që i ka një anëtar i një rrjeti, në mënyrë që të kenë mundësi të zhvillimit dhe rritjes së biznesit të tyre. Përfshirja apo anëtarësimi ka rendësi të veçantë, posaçërisht nga biznese të themeluara dhe udhëhequra nga gratë.

Sipas artikullit "Pse femrat sipërmarrëse duhet t'i bashkohen rrjeteve të grave?" të publikuar në gazetën "Forbes", gratë të cilat janë pjesë e një komuniteti biznesor kanë dy herë shumë gjasë të rritjes së biznesit të tyre se sa ato që nuk i takojnë një rrjeti.

Duke qenë pjesë e një rrjeti, gratë në biznes fuqizohen përmes ekspozimit të bizneseve të tyre, mbështetjes për avancimin e bizneseve të tyre në biznese të qëndrueshme, krijimin e lidhjeve të reja dhe, po ashtu, qasjen në mundësi të ndryshme për financim. Kjo e fundit njihet si një ndër problemet kryesore për të gjitha bizneset në Kosovë, e posaçërisht bizneset e grave.

Gratë të cilat janë në fillimet e bizneseve të tyre janë pikërisht ato të cilat mund të përfitojnë më së shumti duke u bërë anëtare të një rrjeti, gjë që u mundëson të takohen dhe bashkëpunojnë me gra të cilat kanë përvojë më të gjatë në këtë fushë. Me këto të fundit, përveç ndarjes së përvojës



ILIRIANA JAKA GASHI

Drejtoreshë Ekzekutive
OJQ WOMEN 4 WOMEN

dhe mësimëve të përbashkëta, do të mund edhe të mësojnë se cilat janë sfidat që mund t'i presin në rrugëtimin e tyre drejt suksesit.

Koha digjitale në të cilën jetojmë mundëson që gratë ta vazhdojnë bashkëpunimin joformal dhe përmes rrjeteve sociale për t'u bashkërenduar dhe për të siguruar që qasja në informacion të jetë më e lehtë, marrë parasysh që kjo qasje mund të jetë shpeshherë faktori kyç i suksesit.

Krijimi i një ambienti të përshtatshëm për funksionimin e suksesshëm të ndërmarrjeve të udhëhequra nga gratë është synim i përbashkët i çdo gruaje në biznes. Sidoqoftë, gruaja në biznes në Kosovë përballlet me shumë sfida. Avokimi në mënyrë të organizuar, si në rrjete të organizuara, për krijimin e një ambienti të favorshëm për gratë në biznes ofron shumë më shumë sukses se sa avokimi individual.



Sipas artikullit “Pse femrat sipërmarrëse duhet t’i bashkohen rrjeteve të grave?” të publikuar në gazetën “Forbes”, gratë të cilat janë pjesë e një komuniteti biznesor kanë dy herë më shumë gjasë të rritjes së biznesit se sa ato që nuk i takojnë një rrjeti.

Misioni i rrjeteve të grave në biznes mundëson që bizneset, duke ndihmuar njëra tjetrën, të arrijnë të krijojnë ngritje të qëndrueshme, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe përmirësim mirëqenies në Kosovë.

Vendet perëndimore, ku numri i grave ndërmarrëse është i madh, janë të karakterizuara edhe me numër të madh të rrjeteve të grave ndërmarrëse. Në Kosovë, ku kemi numër shumë të vogël të bizneseve në pronësi të grave dhe ku ndërmarrësia e grave është në fazat fillestare edhe nga aspekti kohor, nevoja për të qenë pjesë e rrjeteve të ndryshme është edhe më e madhe. Në Odat Ekonomike të Kosovës numri i grave anëtare është jashtëzakonisht i vogël, por ky nuk është dallim i madh në krahasim me vendet e zhvilluara të cilat u përmendën. Kjo për shkak se zakonisht u jepet prioritet interesave të bizneseve të burrave dhe të cilat zakonisht janë më të mëdha dhe më të fuqishme. Për fat të mirë, ekzistojnë disa organizata joqeveritare të cilat punojnë në krijimin e rrjeteve të grave në biznes dhe që kanë krijuar Forumin Ekonomik të Gruas i cili është anëtar i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Organizata Kosova – Women 4 Women (KW4W), pas një pune 18 vjeçare në ngritjen e vetëdijes së grave të marginalizuara për të drejtat e tyre dhe aftësimin me shkathtësi për t’u punësuar ose vetëpunësuar, në vitin 2017 filloi me përkrahjen e grave pronare ose bashkëpronare të bizneseve në ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe ofrimin e granteve për t’ju ofruar mundësinë e qëndrueshmërisë dhe suksesit.

Puna jonë orientohet në tri drejtime: ndihmesë grave të cilat kanë ide dhe janë të interesuara të themelojnë biznes; përkrahje për bizneset e reja (start-up) dhe bizneset që janë në fillet e veprimtarisë për të fituar stabilitet, si dhe për bizneset e vogla të rriten dhe të punësojnë më shumë gra. Duke qenë se rrjetëzimit të bizneseve i kushtojmë rëndësi të veçantë, përveç takimeve që organizojmë mes tyre përmes aktiviteteve të ndryshme, bizneseve me të cilat punojmë ju ofrojmë qasje në biznes në inkubatorin e themeluar në vitin 2019 duke iu falënderuar Qeverisë së Kosovës. Po ashtu, përmes një konsorciumi ndërkombëtar të programit EYE, financuar nga KE, anëtar të të cilit jemi edhe ne, ju ofrojmë mundësi të filloni bashkëpunim me ndonjë biznes në regjion ose Evropë.



Misioni i rrjeteve të grave në biznes mundëson që bizneset, duke ndihmuar njëra tjetrën, të arrijnë të krijojnë ngritje të qëndrueshme, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe përmirësim mirëqenies në Kosovë.



FKGK PJESË E AECM-SË

31

vende të Europës

AECM është Asociacion European i Institucioneve Garantuese. Gjithsejt numëron 48 anëtarë që operojnë në 31 vende të ndryshme të Europës.

2018

FKGK përfaqësuese në AECM

Që nga viti 2018, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) përfaqëson Kosovën brenda familjes së AECM-së.

1992

themelimi i AECM në Bruksel

AECM me bazë në Bruksel, u themelua në vitin 1992 me tre objektiva kyqe, në vijim:

- 1 Përfaqësimi politik i anëtarëve të saj në institucione të BE-së, Grupit EIB, OECD etj.
- 2 Organizimi i shkëmbimit të praktikave më të mira ndërmjet anëtarëve të AECM
- 3 Promovimi i instrumentit të garancisë

VLERA E SHTUAR

PËR NMVM-të

Qasja në financa për kompani të qendrueshme

Përkrahje e shtuar dhe ekspertizë

Njohja e faktorëve kualitativ gjatë analizave të riskut

Mbulueshmëri gjeografike për NMVM

Në disa skema garantuese përfaqësues të NMVM-ve janë pjesë e menahmentit

PËR AUTORITETET PUBLIKE

Kosto efiçente si rezultat i ndarjes së riskut

Efekt i lartë i Levës

Benefitet i tejkalojnë kostot

Mënyrë efikase e implemetimit të objektivave p.sh. përkrahja publike për sektorë specific

PËR BANKAT

Zvogëlim në ekspozim të rrezikut

Rritje të aktiviteteve kredidhënëse

Garancionet mund të lirojnë kapital

Ekspertizë te shtuar që rezultojnë vendimarrje të fortë

Nivel i lartë i likuiditetit të skemave garantuese

RRITEMI SË BASHKU



PSE MUNGOJNË GRATË NË TRYEZË TË VENDIMMARRJES?

Në nivel global, pozita e grave në menaxhmentin e lartë po rritet në mënyrë graduale. Në vitin 2019, globalisht, përqindja e grave në pozita të menaxhmentit të lartë u rrit në 29%, numri më i lartë i regjistruar ndonjëherë.

Megjithatë, ky progres global nuk pasqyrohet në Kosovë. Tek ne, gratë në tregun e punës ende ballafaqohen me barriera të tejdukshme e kufizuese, veçanërisht nëse synojnë pozita udhëheqëse vendimmarrëse. Pjesëmarrja e grave në tregun e punës është rreth 22.5%. Pra, 78.5% të grave janë joaktive, krahasuar me burrat me 41%. Edhe pse janë bërë përpjekje dhe janë ndërmarrë hapa për ta përmirësuar pozitën e gruas në shoqëri dhe në tregun e punës, shkalla e papunësisë të gratë në Kosovë është akoma e lartë. Përmirësimi i pozitës së gruas në shoqëri kërkon përkushtim nga të gjithë, dhe mbështetje më të madhe përmes politikave favorizuese dhe mekanizmave përkatëse të zbatimit. Mbi të gjitha, kërkohet një zhveshje nga rolet tradicionale gjinore.

Për gratë kosovare, pozitat udhëheqëse në institucione, por dhe në kompani private, mbesin të paarritshme. Numri i grave në pozita menaxhuese në Kosovë mbetet jashtëzakonisht i ulët. Vetëm 3% të pozitave menaxhuese janë gra.

Në shoqërinë tonë patriarkale rolet tradicionale gjinore largohen më vështirë. Në mungesë të politikave për avancim të pozitës së gruas, gruaja është ajo që bart obligimin e përkujdesjes për anëtarët e familjes, për amvisëri, pa e ndarë këtë barrë me askënd, e cila konsiderohet si punë e papaguar. Në mungesë të koordinimit të politikave nga ana e qeverisë për të përmirësuar këtë pozitë, gratë edhe me tutje do të duhet të vendosin ndërmjet punësimit dhe krijimit të familjes, ndërsa burrat janë ata që duhet të punojnë për ta mbajtur familjen. Pafuqia ekonomike



NORA HASANI

Drejtoreshë Ekzekutive
ODA EKONOMIKE GJERMANO KOSOVARE

i bën gratë të pafuqishme edhe në vendimmarrje. Rolet e imponuara tradicionale mbi gratë i vendosin ato në pozitë më të vështirë në negociata qoftë në punë, apo shtëpi.



Për gratë kosovare, pozitat udhëheqëse në institucione, por dhe në kompani private, mbesin të paarritshme. Numri i grave në pozita menaxhuese në Kosovë mbetet jashtëzakonisht i ulët. Vetëm 3% të pozitave menaxhuese janë gra.

Ndërsa po e shkruaj këtë shkrim, jam në zyrën time, jashtë orarit, si shumë herë më parë. Unë jam grua që kam thyer të ashtuquajturin tavan të qelqit*, duke arritur të bëj karrierë në një fushë të dominuar nga burrat. Suksesi në karrierë, si grua në Kosovë, nënkupton angazhim më të madh, më shumë punë, më shumë sakrificë, nevojë shumëfish më të madhe për ta dëshmuar veten sesa burrat, të cilët janë shpeshherë edhe më pak të zotë e më pak të aftë se ti, dhe nevojë për të mos lejuar të jesh e papërgatitur. Ndryshe nuk mund ta sigurosh vendin e barabartë në tavolinën maskuliste. Mirëpo, mbi supet tona hidhet edhe një barrë shtesë. Meqë jemi pak gra në pozita vendimmarrëse, kemi dhe përgjegjësinë të përfaqësojmë jo vetëm punën tonë, por edhe gjininë. Vetëm përmes rezultateve tona në pozita menaxheriale mund të japim kontribut për t'i thyer paragjykimet ndaj grave në udhëheqje. Edhe nëse kjo arrihet, në baza ditore ka përpjekje për të të vendosur një tavan të ri mbi kokë. Sepse, çdo ditë ballafaqohesh me beteja – ku me çdo kusht duan të t'i minimizojnë arritjet. Me çdo kusht duan të të fusin në sirtarë të vegjël të konformitetit me rolet tradicionale gjinore. Po të ishte ndryshe, nuk do të ishim vetëm 3% gra në pozita menaxheriale.

Sociologja gjermane Jutta Allmendinger, në njërën prej intervistave të saj për gazetën "Die Zeit", thotë se gratë që punojnë kanë potencial ta ndryshojnë botën, mirëpo vetëm nëse ndryshojnë strukturat ekzistuese, të cilat në vazhdimësi nxisin stereotipizimin, jo vetëm tek punëdhënësit.

Situata në terren është e dhimbshme, sepse çdo herë bëhet më e qartë se gratë mungojnë në menaxhment në ndërmarrje private. Në shumicën dërrmuese të rasteve, gratë merren me financa, ndonjë herë caktohen në pozitë tjetër operacionale, mirëpo ato nuk janë të pranishme në takimet vendimmarrëse, ato nuk pyeten, ato nuk marrin pjesë në diskutime. Natyrisht, ka përjashtime, por përjashtimet nuk e krijojnë rregullën.

Kompanitë duhet të punojnë drejt balansimin gjinor si arritje përfundimtare.



Faktorët kyçë që pengojnë gratë të arrijnë pozita vendimmarrëse janë: kultura e kompanive, paragjykimet ndaj grave, diskriminimet në baza gjinore në kuptim të punësimit dhe, më pas, avancimit në karrierë. Si dhe beteja e përhershme e balancimit të përgjegjësive shtëpiake e familjare

Si vullnet dhe përkushtim i përmirësimit të sistemit nga brenda, e jo vetëm si çështje të identifikuar nga departamenti i burimeve njerëzore, apo si lehtësirë për të përfitur grante.

Faktorët kyçë që pengojnë gratë të arrijnë pozita vendimmarrëse janë: kultura e kompanive, paragjykimet ndaj grave, diskriminimet në baza gjinore në kuptim të punësimit dhe, më pas, avancimit në karrierë. Si dhe beteja e përhershme e balancimit të përgjegjësive shtëpiake e familjare (mos t'i harrojmë rolet tradicionale gjinore, që i përmendëm pak më parë!). Pastaj mungon legjislacioni përkatës për përkrahje për orar fleksibël të punës, ligji i punës, gjersa dispozitat e pushimit të lehonisë, pushimi i atësisë dhe pushimi prindëror mbesin kërkesa të cilat duhen përmbushur. Sektori privat në Kosovë duhet të zhvishet nga kultura tradicionale, meqë edhe në biznese familjare dominojnë burrat. Për shkak të paragjykimeve që kanë, në situata të ndryshme në takime pune, në evente ku kërkohet paraqitja ime - fillimisht më orientonin drejt hapësirave ku qëndronin gratë e pronarëve, dhe jo vetë

pronarët apo drejtorët e kompanive. Sepse "gratë rrinë te gratë dhe nuk përzihen me burra". Irritimi që e shoh dhe e ndiej kur ngul këmbë të qëndroj aty ku e kam vendin është i dhimbshëm – meqë sjell në pah rrënjët e thella të patriarkatit në shoqërinë tonë pseudo-moderne, ku rreth 79% të grave janë joaktive në tregun e punës.

Në takimet e mia të para në pozitën e drejtoreshës ekzekutive, reagimi i parë në shumë raste ishte "Ku është shefi?". Kur arritëm në etapën e etabilimit të autoritetit dhe dëshmisë së kompetencës se kush është shefi, pa marrë parasysh moshën dhe gjininë time, tema kyçe edhe sot e kësaj dite mbetet pse diskriminoj burra dhe punësoj gra. Me ekipin tim që përgjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit të organizatës sonë ka qenë i përbërë vetëm nga gra, nuk kemi thyer vetëm barriera të tejdukshme, por edhe shumë paragjykime që dominojnë shoqërinë kosovare dhe kemi nxitur, direkt dhe indirekt, diskutime rreth punësimit të grave. Nuk mbaj mend të kem dëgjuar një diskutim të tillë, kur të punësuar janë vetëm burra, apo më shumë burra se gra – qoftë në institucion

apo ndërmarrje. Në atë rast merret si e mirëqenë, dhe nuk përbën diskriminim.

Vitet e fundit, edhe pse me ritëm të vogël, gratë kosovare po mundohen t'i tejkalojnë vështirësitë dhe qëndrimet negative ndaj tyre, por dhe të jenë më të guximshme ta kërkojnë vendin e tyre në tryezat vendimmarrëse. Deri sa të arrijmë të kemi më shumë progres, është edhe obligim i grave që kanë arritur ta thyejnë tavanin e trashë të qelqit në Kosovë që të pyesin se "pse mungojnë gratë në tryezën vendimmarrëse" dhe duhet të nxisin qoftë në mënyrë direkte qoftë indirekte debatet rreth punësimit dhe përfaqësimit të grave.

***Çfarë është tavani i qelqit?**

Tavani i qelqit është metaforë për pengesën e padukshme që në shumicën e rasteve pengon gratë në punë, dhe gratë që duan të ngriten në poste të larta.

Autorja është Drejtoreshë Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare. Qëndrimet e shprehura janë personale dhe nuk shprehin qëndrimet e institucionit.



SHTËPIA E DJATHIT - NATYRA G

Drugës tonë nga Prishtina për në Ferizaj, nëpër rrugën e vjetër, jo shumë larg hyrjes në Ferizaj, në vendin e quajtur Prelez i Muhaxherëve, në mesin e shumë bizneseve ndodhet edhe biznesi që vizituar, shtëpia e djathit NAYRA-G.

Një zonjë e buzëqeshur e plot energji, Shemsija, na pret në vendpunimin të cilin ajo së bashku me bashkëshortin, Idrizin, e filluan në vitin 2011. Është kjo fabrika e prodhimeve të qumështit natyral, me llojllojshmëri produktesh, si djathë, kaçkavall, gjizë, kos, jogurt, e shumë lloje produktesh tjera që shquhen për origjinalitet dhe janë produkte krejtësisht natyrale. Në të gjenden shumë makineri të reja në të cilat përpunohen, paketohen dhe përgatiten për shpërndarje produktet e qumështit.

"Këtu, gjithçka është BIO, sepse ky është koncepti i biznesit tonë që e dizajnuam qysh në fillim" - na thotë zonja Shemsija, një punëtore e madhe që me shumë mund e nisi dhe ngriti këtë biznes.

"Gjithnjë kam ëndërruar ta rris biznesin, që të kemi pajisje moderne dhe të sofistikuara që e lehtësojnë dhe mundësojnë prodhim

cilësor të produkteve natyrale. Tanimë, kemi arritur t'i kemi pajisjet e dëshiruara, i kemi blerë përmes kredisë që e shfrytëzuar, e që na është garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. Këtë kredi na kanë aprovuar shumë shpejtë, pa kolateral dhe me procedura të shkurtuara. Si klient që kemi paguar rregullisht këstet dhe kreditë, kishim përparësi dhe u kualifikuar që të investojmë edhe më tutje në biznesin tonë" - tha Shemsija.

Tanimë kemi rritur kapacitetet dhe kemi mbi 20 punëtorë të rregullt. Sot punojmë me kapacitet përpunimi prej 2,500 litra qumësht brenda ditës, edhe pse kemi mundësinë deri në 70,000 litra, që është edhe synimi ynë për të ardhmen - tha zotëri Idrizi, burrë që gjithmonë i rri krahu Shemsijes, e cila shquhet për organizim dhe kryerjen e të gjitha punëve operative që kërkon ky biznes.

Natyrë G, aty ku janë të angazhuar e gjithë familja, ka ndërtuar dhe ngritur fabrikën vit pas viti duke investuar dhe rritur kapacitetet prodhuese nga qumështi krejtësisht natyral.



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garantimin e Kredive të krijuar sipas Rregullores (EU) Nr 1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e Programit për Konkurrencë dhe Ndihmë të Ndermarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014 - 2020).



Mbështetja e këtij investimi është bërë përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore së bashku me Programin COSME të Fondit Evropian për Investime, të cilët janë duke mbështetur qasjen në financa për NMVM-të në fazat e ndryshme të ciklit të jetës së tyre, si gjatë krijimit, zgjerimit ose transferimit të biznesit.



TË ARRITURAT DERI MË 31 DHJETOR 2021

16,390

VENDE TË REJA PUNE

1,174



Bujqësi, pylltari
dhe peshkatari

3,279



Prodhim

5,561



Tregti me
 shumicë e pakicë

1,717



Ndërtimtari

4,659




Shërbime

Parashikim i raportuar nga MVM-të

KREDI PËR GRATË NË BIZNES


12.5% e kredive të garantuara
janë për gratë ndërmarrëse



12.5%



TË ARRITURAT E FKGK-së DERI MË 31 DHJETOR 2021



FKGK PJESË E PANELIT NË WEBINAR “FINANCAT E QËNDRUESHME PËR INSTITUCIONET FINANCIARE”

Korrik 2021 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesë e panelit në webinar-in “Financat e Qëndrueshme për Institucionet Financiare / Sustainable Finance for Financial Institutions” të organizuar nga International Finance Corporation (IFC) dhe Recura sh.a. në bashkëpunim me Sekretariati Zviceran për Çështjet Ekonomike SECO. Në këtë panel Menaxherja e Lartë e Garancioneve në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore znj. Nora Arifi, njoftoi pjesëmarrësit për veprimtarinë aktuale të FKGK-së lidhur me Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS), për mbështetjen e dhënë për implementimin e SMMS edhe nga ana e Institucioneve Financiare të Regjistruara në FKGK, si dhe për masat që po ndërmerren nga FKGK-ja në mënyrë që të sigurojë që kreditë e garantuara të kanë një ndikim pozitiv klimatik duke i'u nënshtruar kontrollit mjedisor dhe kujdesit të duhur në përputhje me kërkesat e SMMS.



FKGK FILLON ME ZBATIMIN E PLOTË TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Korrik 2021 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore tashmë ka filluar me zbatimin e plotë të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor e Social (SMMS). Në përputhje me përpjekjet tona institucionale për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, me përgjegjësi të plotë për mjedisin dhe shoqërinë, FKGK së bashku me IRF-të do të përdorin standardet më të larta mjedisore dhe sociale për të zbutur ndikimet e pafavorshme mjedisore të projekteve të financuara.

MBAHET FORUMI I SOLARËVE

Korrik 2021 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesëmarrëse në Forumin e Solarëve që u organizua nga Ministria e Ekonomisë dhe USAID. Qëllimi i këtij Forumi ishte të promovojë dhe paraqitjes së tregjeve të vetë konsumit dhe projekteve të reja solare në Kosovë. Në këtë ngjarje u lansua web faja si dhe u diskutua draft koncept dokumenti që flet për Ligjin për Energji të Ripërtrishme.

PUBLIKOHET RAPORTI VJETOR 2020

Gusht 2021 - Ky raport paraqet rezultatet, aktivitetet e FKGK-së përgjatë vitit 2020, ku FKGK ka vazhduar në ndjekjen e misionit drejt fuqizimit të kredithënies për NMVM-të si dhe mbështetjen për rimëkëmbjen e sektorit privat dhe ekonomisë kosovare në përgjithësi. Përkundër krizës shëndetësore dhe ekonomike, pikërisht atëherë kur perceptimi i riskut kreditor në treg vlerësohej si shumë i lartë, pa asnjë mëdyshje ne vazhduam të mbajmë hapur dy dritaret garantuese ekzistuese, atë të rregullt dhe dritaren e agros.

Ishte ky një mesazh që reflektonte konfidencë dhe siguri për partnerët tanë, që më pastaj u vlerësua me shumë pozitivitet nga komuniteti bankar dhe ai i biznesit privat. Poashtu, FKGK luajti rol thelbësor gjatë të gjitha fazave të dizajnit dhe implementimit të programit të rimëkëmbjes ekonomike, program ky që arriti kulmin me lansimin e pesë dritareve garantuese, e që kishte për qëllim rritjen e konfidencës në kreditim, duke rritur mbulueshmërinë e riskut kreditor deri në 80%, për sektorë të caktuar ekonomikë.



FKGK LANSON DRITARËN START-UP NË KUADËR TË DRITAREVE TË PAKOS SË RIMËKËMBJES EKONOMIKE

Gusht 2021 – FKGK lanson Dritarën Start-up në kuadër të dritareve të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Dritarja Start-up është një linjë e re garantuere që do të operojë në kuadër të FKGK-së dhe që ka për qëllim mbështetjen e Ndërmarrjeve të reja përmes garantimit të kredive. Kjo dritare, parasheh të rritë mbulueshmërinë me garancion kreditor deri në 80% të vlerës së kredisë, dhe njëkohësisht do të adresojë nevojat e këtij segmenti të caktuar të tregut.

Nga kjo dritare pritet të ndihmohet qasja në financa për ndërmarrjet e reja të ndikuara nga kriza. Dritarja Start-up pritet të mbështesë qasjen në financa për ndërmarrjet e reja në vlerë deri në 2 MM € për periudhën kohore deri më 31 dhjetor 2021. Kjo dritare në këtë kohë pandemie, do të ketë vlerë të shtuar si për përfituesit e fundit (Bizneset Start-up) të cilëve do të ju mundësohet qasje në financa me kushte më të mira të kredidhënies, ashtu edhe për Institucionet Partnere Financiare (IPF) të cilat do të kenë mundësi të ndajnë një pjesë të madhe të riskut kreditor me FKGK-në. Një dritare e tillë është vlerësuar nga Institucionet Financiare të cilat e shohin si të domosdoshëm mbështetjen për bizneset e reja të cilat kanë qasje më të limituar në financa. Kjo ngjarje shënon një moment të radhës për Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë, në rrugën e realizimit të objektivave institucionale, para se gjithash, lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e reja.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E GARANCISË ME KREDITIMIN RURAL TË KOSOVËS

15 Shtator 2021 - Në ambientet e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), u nënshkrua Marrëveshja e Garancisë me Kreditimin Rural të Kosovës (KRK). Kjo marrëveshje u nënshkrua për garantimin e kredive bujqësore brenda Dritaresh Agro të FKGK-së. Kjo ngjarje shënon më tutje zgjerimin e marrëveshjeve që FKGK realizon gjatë këtij viti me Institucionet Mikrofinanciare duke ofruar garanci për kredi bujqësore për fermerët dhe agrobizneset vendore. Deri më tani janë garantuar rreth 27 milion euro – kredi bujqësore dhe janë rreth 9 milion euro garanci aktive në këtë sektor. Kapitali i përgjithshëm i Dritaresh Agro është në vlerë totale prej 11.5 milion euro që është financuar plotësisht nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës Gjermane për Zhvillim – KfW.



FKGK MBANË TAKIME VIRTUALE ME GRA NË BIZNES - ORGANIZUAR NGA RIINVEST

Shtator 2021 – FKGK organizoi takime virtuale me gra të përfshira në biznes, me ç’rast u prezantua puna e Fondit dhe Skemave Garantuese.




SESIONE ORIENTUESE PËR DRITAREN START-UP

Shtator 2021 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti sesione orientuese për Dritaren Startup pas marrëveshjeve të nënshkruara me IRF-të. Në pesë sesione të organizuara në të cilat morën pjesë rreth 255 i IRF-ve u diskutua rolin e skemave garantuese, dritaret në kuadër të PRE-së me theks të veçantë në Dritaren Startup të lansuar në gusht të këtij viti.



FKGK MBANË TAKIME VIRTUALE ME START-UP, NË BASHKËPUNIM ME GIZ

Tetor 2021 - U mbajt takimi virtual në bashkëpunim me GIZ, me ç’rast u prezantua skema garantuese e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore si dhe u shpalosën informatat rreth skemave garantuese dritares StartUp që është e dizajnuar për këtë kategori.



TRAJNIME PËR STAFIN E KRK-SË - DRITARJA AGRO – PËRDORIMI I AGROSOFT-IT

Tetor 2021 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti trajnime rreth përdorimit të platformës AgroSoft, me stafin e Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) pasi u nënshkrua marrëveshja me ta. Ky trajnim, është pako e vazhdueshme që FKGK mbanë për IRF-të, ku përmes kësaj platforme, FKGK-ja ndihmon qasje më të lehtë në financa për fermerë dhe agrobiznese vendore. Në këtë trajnim u mbajtën në tri grupe dhe gjithsej të trajnuar janë 61 staf të KRK-së.



U MBAJT PUNËTORIA ME GAZETARË GAZETARIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE 2021 "TË BËJMË LAJME NGA NUMRAT"



Tetor 2021 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës, organizuan punëtorinë dy ditore me temën: **"Gazetaria ekonomike dhe financiare 2021– Të bëjmë lajme nga numrat"**.

Në këtë punëtori ishin prezent gazetarë, të shumë mediave audiovizuale si dhe online. Në këtë punëtori u diskutua për: sektorin bankar, rëndësinë e skemave garantuese dhe tema për ekonominë në përgjithësi. Përfaqësues të institucioneve të Kosovës BQK, ATK; Thesari i Kosovës, MINT; donatorë - KfW si dhe përfaqësues të biznesit ishin pjesë e paneleve dhe prezantuan për temat:

- Efekti i pandemisë Covid19 në sistemin bankar dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë;

- Bashkëpunimi ndërinstitucional me sistemin financiar për të ruajtur stabilitetin dhe nxitur zhvillimin ekonomik;

- Masat e qeverisë për rimëkëmbje ekonomike.

Kjo punëtori solli një atmosferë bashkëpunuese dhe ishte mundësi e mire për të gjithë pjesëmarrësit të diskutojnë së bashku rreth sektorit bankar & ekonomisë.



TRAJNIME PËR KATEGORIZIMIN MJEDISOR – POLITIKAT E MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Tetor 2021 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë mbajti trajnime rreth zbatimit të SMMS për IRF-të. Këto trajnime janë optimizuar bazuar në kapacitetet egzistuese të Institucioneve të regjistruara financiar. Janë mbajtur tri seanca me nga 20 pjesëmarrës, staf i KRK-së. Numri i stafit të trajnuar arriti shifrën 61. FKGK në vazhdimësi mbanë trajnime për SMMS varësisht nga vlerësimi dhe kërkesat e IFR-ve.



PJESËMARRJA E STAFIT TË FKGK-SË NË PANELE DISKUTIMESH "JAVA E NDËRRMARRËSISË GLOBALE"

Nëntor 2021 - TEB organizoi diskutimin me temën "Qasja në Financa për Gratë Ndërmarrëse" Përfaqësues shtetëror, të institucioneve ndërkombëtare e vendore bashkë me përfaqësues të Bankës TEB kanë diskutuar për financimin e aktiviteteve afariste të Grave ndërmarrëse duke shënuar Javën Ndërkombëtare të Ndërmarrësisë (Global Entrepreneurship Week).



QASJA NË FINANCA PËR START-UP



Nëntor 2021 -Me qëllim të shënimit të Javës Globale të Ndërmarrësisë (GEW), VentureUp organizoi takim me StartUP: Takimi ka dy pika kryesore të diskutimit: 1) sfidat e ndërmarrësve në Kosovë, dhe 2) mundësitë për qasje në financa për startupet në Kosovë. Takimi organizohet së bashku me Jakova Innovation Centre (JIC) ne bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë, EBRD, dhe disa banka që do të shpalosin ofertat e tyre financiare specifike për startupet.

GJERMANIA MBËSHTET FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE (FKGK)

25 Nëntor 2021 - Nënshkruhet marrëveshja mes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe KfW – Banka Gjermane për Zhvillim. **6 milion euro shtesë për FKGK ku ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të përfitojnë nga investimet e gjelbra.** Hapjen e bëri z. Rinor Gjonbalaj – Kryesues i Bordit të FKGK-së. Këtë marrëveshje e nënshkruan nga Dr. Klaus-Martin Müller, Drejtor për Europën Juglindore dhe Turqi nga KfW- Banka Gjermane për Zhvillim dhe z. Besnik Berisha – Drejtor Menaxhues i Fondit për Garanci Kreditore. Në shenjë falenderimi për përkrahjen e vazhdueshme nga KfW – Banka Zhvillimore Gjermane, gjatë ceremonisë ju nda edhe një plaketë mirënjohjeje nga Drejtori Menaxhues z. Besnik Berisha. Në ceremoninë e nënshkrimit ishin të pranishëm z. Hekuran Murati – Ministër i Financave në Republikën e Kosovës; z. Jörn Rohde – Ambasador i Gjermanisë në Republikën e Kosovës; Fehmi Mehmeti Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës; Dr. Klaus-Martin Müller, Drejtor për Europën Juglindore dhe Turqi nga Banka Gjermane për Zhvillim – KfW; të cilët mbajtën nga një fjalim rasti në këtë ceremoni.



FKGK PJESË E PANELIT ORGANIZUAR NGA PROGRAMI I USAID - KOSOVO COMPETE ACTIVITY

Dhjetor 2021 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte pjesë e panelit në ngjarjen “Partneriteti Ndërmjet Shitësve të Pajisjeve me Lizing dhe Institucioneve Financiare të Lizingut në Industrinë e Përpunimit të Drurit” organizuar nga Programi i USAID-it Kosovo Compete Activity në bashkëpunim me Shoqatën e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPKD) dhe Raiffeisen Leasing Kosova (RLKO). Në këtë panel Menaxherja e Lartë e Garancioneve në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore znj. Nora Arifi, njoftoi pjesëmarrësit se në kuadër të PRE-së, FKGK ka dizajnuar dritare që adresojnë sektorin e prodhimit, si dhe masat që do të ndërmerr në vazhdim në mënyrë që të mbështes këtë sektor që ndihmon zhvillimin ekonomik dhe rritjen e eksportit.



FKGK NË MEDIA

Shtator 2021 - Intervistë me z. Kastriot Këpuska, Agro Ekspert, në emisionin “7 ditë me Panxhën” në Klan Kosova. Tema e diskutimit ishte “Garancionet dhe financimi i bazuar në kontrata”. U diskutua lidhur me financimin e sektorit të bujqësisë dhe rolin që FKGK në financimin e shumë sektorëve të ekonomisë me theks të veçantë gjatë pandemisë.



Shtator 2021 - Intervistë me Menaxherin e lartë të Riskut të FKGK-së z. Alban Krasniqi, në programin e mëngjesit në RTK - “Mirëmengjesi Kosovë” ku u diskutua lidhur me rolin e FKGK-së në kuadër të PRE-së, skemat garantuese si dhe për dritaren StartUP.



Shtator 2021 - Intervistë me Menaxheren e Lartë të Riskut të FKGK-së z. Nora Arifi në programin e mëngjesit në ATV me ç'rast përveç që u diskutua për FKGK-në dhe skemat garantuese në përgjithësi, në këtë emision u promovua dritarja Start-Up, u fol për kushtet dhe karakteristikat e Dritares Start-UP.



Tetor 2021 - Intervista e Drejtorit Menaxhues në EkonomiaOnline - FKGK me 40 milionë € shtesë, përparësi bizneset që nuk i sjellin dëm ambientit. Drejtori Ekzekutiv i FKGK-së, Besnik Berisha, tha për Ekonomia Online se këto mjete do të ndahen për bizneset që do të kalojnë procesin e vlerësimit nga bankat financiare në Kosovë. “Pjesa e 40 milionëshit që parashihet të dhurohet nga Qeveria e Kosovës nga Kredia prej Bankës Evropiane të Investimeve do të jetë për qëllim të rritjes së kapitalit të FKGK-së, kapital ky që do të shërbej për mbështetjen e operacioneve bazë të Fondit e që është ofrimi i garancioneve kreditore për bankat partnere në sektorin financiar të Kosovës”.




Nëntor 2021 - Paraqitja në programin e mëngjesit “SOT” në Kohavision - 40 Milion Euro ndihmë NMVM-ve, flet Drejtori i FKGK-së – z. Besnik Berisha.
Nëntor 2021 - Paraqitje në lajmet e orës 15:00 në RTK, ku u fol për aprovimin e kapitalit shtesë në shumë 40 milion Euro. Kapital shtesë nga EIB për FKGK-në.






ZHVILLIMI I PORTFOLIOS SË DRITAREVE NË KUADËR TË PAKOS SË RIMËKËMBJES EKONOMIKE

ZHVILLIMI I PRE-së



ZHVILLIMI I PORTFOLIOS SIPAS SECILËS DRITARE

DRITARET E PRE-së



Shuma e kredisë
Shuma e garancisë
Numri

Shuma e kredisë	105,555,705	11,736,215	6,971,200	28,719,074	25,453,740	31,840,876	834,600
Shuma e garancisë	74,948,973	8,592,222	5,226,910	19,943,859	17,956,255	22,572,077	657,650
Numri	2,015	269	152	394	593	572	35

URIMI NGA EKIPI I FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Buletin i FKGK-së

EDICIONI I TRETË | Dhjetor 2021

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:
Njazi Alishani Nr. 5,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 225 600
info@fondikgk.org

www.fondikgk.org